

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

PËR VIJIMIN E FUNKSIONIMIT TË MEKANIZMIT TË KOORDINUAR TË REFERIMIT TË RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE (MKR) NË FUSHË ARRËZ

Përditësuar në përputhje me ndryshimet e kuadrit ligjor, konkretisht Ligjit nr.125/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar”, si dhe VKM 327/2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”

Ri-nënshkruar

sot, më datë _____ 2024, në Fushë Arrëz,

ndërmjet palëve si më poshtë vijon:

A. Institucioneve në cilësinë e anëtarëve të përhershëm të Komitetit Drejtues, sipas VKM 327/2021, si në vijim:

- 1. BASHKIA E FUSHË-ARRËZ, përfaqësuar nga Z. Hil CURRI, Kryetar;**
- 2. PREFEKTURA SHKODËR, përfaqësuar nga, Zj.Majlinda Angoni, Prefekte;**
- 3. STACIONI I POLICISË FUSHË-ARRËZ, përfaqësuar nga Z. Bardhi Ibraliu, Officer;**
- 4. NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSORË PUKË, përfaqësuar nga Zj.Besmira Aliaj, Drejtoreshë;**
- 5. SPITALI PUKË, përfaqësuar nga Z.Qazim Arifaj, Drejtor;**
- 6. ZYRA VENDORE ARSIMORE PUKË, përfaqësuar nga Znj.Blerinda Pemaj, Drejtoreshë;**
- 7. ZYRA VENDORE E PUNËSIMIT PUKË, përfaqësuar nga Z. Pjetër Gjergji, Drejtor;**
- 8. DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR, përfaqësuar nga Znj. Daniela Jakoja, Drejtoreshë;**

9. SHOQATA “QSNNN”, përfaqësuar nga **Znj. Pamela Gjinaj**;
10. SHOQATA “ GRUAJA TE GRUAJA”, përfaqësuar nga **Zj. Trendelina Boriçi, Presidente**;
11. Shoqata Komuniteti “PAPA XHOVANI XXIII ”, përfaqësuar nga **Zj.Mira Prekperaj, Drejtoreshë**;

B. Institucioneve në cilësinë e anëtarëve të ftuar të Komitetit Drejtues, sipas VKM 327/2021, si në vijim:

1. **ZYRA VENDORE E PËRMBARIMIT GJYQËSOR PUKË**, përfaqësuar nga **Z. Zef Kolombi, Kryetar**;
2. **ZYRËN VENDORE TË SHËRBIMIT TË PROVËS PUKË**, përfaqësuar nga **Z.Artan Seferi, Drejtor**
4. **MJEKU LIGJOR SHKODËR**, përfaqësuar nga **Z.Dhori Toshi, Mjek**;
5. **GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SHKODËR**, përfaqësuar nga **Z. Arbër Çela, Kryetar**;
6. **PROKURORIA PRANË SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SHKODËR**, përfaqësuar nga **Z.Albert Murçaj, Prokuror**;

Palët bien dakord si më poshtë vijon:

NENI 1 Objekti

Objekti i kësaj marrëveshje është konfirmimi i vijueshmërisë së punës së Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR) në Bashkinë Fushë Arrëz, i ngritur që në vitin 2019, me nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse, të përcaktuara për të qenë anëtare të këtij mekaniizmi sipas legjislacionit në fuqi në atë periudhë. Në mënyrë specifike, objekti i kësaj marrëveshjeje është koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve dhe autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e dhunës në familje, për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të të gjitha formave të dhunës në familje, duke garantuar të drejtat e njeriut e promovuar barazinë gjinore, si edhe eliminuar të gjitha format e diskriminimit ndaj grave.

NENI 2 Baza ligjore

Kjo marrëveshje bashkëpunimi bazohet në parimet e sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, Konventën e Këshillit të Evropës, “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” dhe në aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Në mënyrë specifike, kjo marrëveshje bazohet në Ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i përditësuar (ndryshuar me ligjin nr.9914, datë 12.5.2008, ligjin nr.10 329, datë 30.9.2010, ligjin nr. 47, datë 23.7.2018 dhe ligjin nr.125 datë 15.10.2020), neni 8, pikat 1 dhe 8 të tij; Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Brendshme Nr. 866, datë 20.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”; Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Brendshme Nr. 912, datë 27.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e urdhrat për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”; si dhe VKM 327/2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës”. Gjithashtu kjo marrëveshje është në linjë edhe me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 dhe Planit të saj të Veprimit (qëllimi strategjik 3), miratuar me VKM 400/2021 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021–2030, dhe të planit të saj të veprimit”.

NENI 3 Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është në përputhje me qëllimin e bazës ligjore mbi të cilën hartohet dhe konsiston në marrjen e masave të nevojshme përmes një koordinimi ndër-institucional për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore dhe të masave të tjera të nevojshme, si dhe për garantimin e mbrojtjes me masa ligjore dhe me masa të tjera të nevojshme të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarave/moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar, si dhe të çdo individi, të cituar si subjekt i Ligjit nr.9669/2016,

sipas nenit 3, të tij¹, që paraqet nevoja të veçanta mbrojtjeje. Koordinimi dhe bashkërendimi i veprimeve me synim rritjen e efektivitetit të funksionimit dhe ofrimin e shërbimeve shumë-sektoriale, qëndrojnë në themel të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit.

NENI 4

Përbërja e MKR Fushë Arrëz

Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje në Bashkinë Fushë Arrëz, përbëhet nga:

- a) **Komiteti Drejtues për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje.** Përfaqësueset/përfaqësuesit në komitetin drejtues janë në nivel drejtuesesh/drejtuesish, për institucionet që funksionojnë në nivelin e Bashkisë Fushë Arrëz, si dhe në nivel përfaqësuesesh/përfaqësuesish të deleguar nga titullaret/titullarët, për ato institucione të cilat funksionojnë në nivel qarku. Komiteti drejtues mbledhet së paku një herë në tre muaj në mbledhje të zakonshme dhe sipas nevojave në mbledhje të jashtëzakonshme. Të drejtën për të kërkuar mbledhjen e komitetit drejtues dhe përfshirjen e çështjeve në rendin e ditës, si dhe të ftuarave/ftuarve, e ka kryetari i bashkisë ose jo më pak se tre anëtare/anëtarë. Pjesëmarrja e anëtareve/anëtarëve të komitetit drejtues në mbledhjet e tij është e detyrueshme. Në rastet kur njëri nga anëtarët/anëtarët e komitetit drejtues nuk mund të marrë pjesë në mbledhje, mungesa duhet të justifikohet me anë të një njoftimi me shkrim, në mënyrë elektronike dhe në formë shkresore. Në këtë rast, titullarja/titullari i institucionit përkatës cakton një zëvendësuese/zëvendësues për të marrë pjesë në atë mbledhje të komitetit drejtues. Mungesa e pajustificuar në më shumë se dy mbledhje radhazi sjell zëvendësimin e anëtares/anëtarit. Çdo anëtare/anëtar i komitetit drejtues është i detyruar të informojë me shkrim titullaren/titullarin e institucionit përkatës, si dhe çdo strukturë tjetër përgjegjëse për vendimet ose masat e marra nga komiteti drejtues, me qëllim marrjen në kohë të masave që lidhen me veprimtarinë e asaj strukture. Komiteti drejtues në marrëdhëniet me organet e pushtetit qendror dhe vendor përfaqësohet nga kryetari i bashkisë. Komiteti drejtues për veprimtarinë e tij i raporton çdo tre muaj ministres/ministrit përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje. Pjesë e

¹Sipas Ligjit 9669/2006, i ndryshuar, neni 3/7. “Pjesëtarë të familjes” janë:

- a) bashkëshorti/bashkëshortja ose bashkëjetuesi/bashkëjetuesja apo ish-bashkëshorti/bashkëshortja apo ish-partneri/partnerja bashkëjetues;
- b) vëllezërit, motrat, përfshirë, sipas rastit, edhe bashkëshortin/bashkëshorten ose bashkëjetuesin/bashkëjetuesen e tyre, si dhe nipin e mbesën, nëse këta të fundit janë anëtare/anëtarë të njësisë shtëpiake;
- c) paraardhëset/paraardhësit dhe pasardhëset/pasardhësit në vijë të drejtë, pa kufizime, përfshirë edhe rastet kur kjo marrëdhënie krijohet nëpërmjet birësimit;
- ç) prindërit e bashkëshortit/bashkëshortes ose të bashkëjetuesit/bashkëjetueses, përfshirë dhe thjeshtrin/ thjeshtrën, edhe sikur kjo lidhje të burojë nga birësimi;
- d) gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit, edhe fëmijët e birësuar të bashkëshortit /bashkëshortes ose bashkëjetuesit/bashkëjetueses;
- dh) vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit, bashkëshortes, bashkëjetuesit/bashkëjetueses;
- e) fëmijët e bashkëshortëve ose partnerëve bashkëjetues;
- ë) personat, të cilët janë ose kanë qenë në marrëdhënie intime, jo domosdoshmërisht të shoqëruar me bashkëjetesë, gëzojnë të njëjtën mbrojtje;
- f) kujdestari dhe personi që ndodhet në kujdesin e tij gjatë kohës që vazhdon kujdestaria, sipas përcaktimeve të kujdestarisë mbi të miturat/miturit dhe kujdestarisë për personat me aftësi të kufizuara dhe personit që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar sipas dispozitave të Kodit të Familjes”.

raportimit janë të dhënat e problemet e evidentuara për dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave, në territorin e Bashkisë Fushë Arrëz, duke paraqitur sipas rastit edhe propozime konkrete për mbështetjen që kërkohet nga autoriteti kryesor përgjegjës ose/dhe autoritetet e tjera të linjës. Komiteti drejtues, sipas problematikës së evidentuar, vë në dijeni, për sa më sipër, njërin prej ose të gjitha autoritetet përgjegjëse të linjës sipas parashikimeve të ligjit në fuqi për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare. Një kopje e raportit i vihet në dispozicion Këshillit Bashkiak dhe Këshillit të Qarkut. Përfaqësueset/përfaqësuesit e autoriteteve të tjera shtetërore në nivel vendor, të cilat/cilët janë anëtarë/anëtarë të komitetit drejtues, raportojnë çdo tre muaj në institucionet e tyre qendrore për veprimtarinë e tyre në komitetin drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje. Në raportimet periodike që paraqiten, komiteti drejtues kujdeset që të ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave.

- b) Ekipi Teknik Ndërdisiplinor (ETN).** Ekipi Teknik Ndërdisiplinor ngrihet me vendim të Komitetit Drejtues me qëllim bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor. ETN përbëhet nga përfaqësuese/përfaqësues teknikë të institucioneve që janë të përfaqësuara në Komitetin Drejtues dhe drejtohet nga Koordinatorja Vendore. Përfaqësueset/përfaqësuesit e institucioneve, që janë anëtarë të ETN, kanë mandat dyvjeçar me të drejtë ripërtëritje, i cili mund të ndërpritet vetëm në rastin e transferimit në një detyrë tjetër. ETN-ja mbledhet në mbledhje të zakonshme çdo muaj dhe në mbledhje të jashtëzakonshme sa herë që lind nevoja për raste konkrete të dhunës në familje dhe të dhunës ndaj grave. ETN, në bashkëpunim me Grupin Teknik Ndërsektorial për të drejtat e fëmijëve (GTN), organizojnë mbledhje të përbashkëta rast pas rasti, kur dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave shoqërohet edhe me dhunën ndaj fëmijëve ose kur përfshihen fëmijët si dëshmitarë të dhunës në marrëdhëniet familjare.
- c) Koordinatorja Vendore (KV) për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare.** KV caktohet në organikën e bashkisë në zyrë të dedikuar posaçërisht për kryerjen e këtij funksioni, dhe nuk ka në përshkrimin e punës mbivendosje me detyra të tjera. Pozicioni i punës së KV është me kohë të plotë dhe në çdo rast bashkëpunon me nga një administratore /administrator shoqëror/punonjëse/punonjës social, për çdo njësi administrative. KV paraqet raporte mujore, tremujore dhe vjetore përpara Komitetit Drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, në formë të përmbledhur, duke u kujdesur që të ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave. Këto raporte përmbajnë informacion për rastet në të cilat është ndërhyrë, për procedurat e ndjekura, masat e ndërmarra dhe problemet e ndeshura, që mund të kërkojnë zgjidhje nga Komiteti Drejtues. KV është anëtarë e grupit që përgatit planet sociale, ku analizohen nevojat sociale dhe parashikohen masat për përmirësimin ose ngritjen e shërbimeve të reja për subjektet e përfshira në dhunën në familje, si dhe anëtarë e grupit që përgatit planet vendore për barazinë gjinore në nivel vendor.

Përveçse përshkrimit të mësipërm, detyrat dhe përgjegjësitë specifike për Komitetin Drejtues, Ekipin Teknik Ndërdisiplinor dhe Koordinatorin Vendore paraqiten në mënyrë të detajuar në VKM 327/2021 dhe janë të detyrueshme për zbatim nga ana e tyre.

NENI 5 Parimet e MKR

Veprimtaria e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje mbështetet e udhëhiqet nga këto parime:

- a) shërbime lehtësisht të aksesueshme dhe të arritshme,
- b) trajtimi me respekt e dinjitet i viktimave,
- c) ndalimi i viktimizimit, riviktimizimit dhe viktimizimit dytësor,
- ç) konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale,
- d) siguria e jetës dhe e shëndetit,
- dh) ndalimi i diskriminimit,
- e) trajtimi efektiv dhe përkujdesja individuale,
- ë) mbështetja dhe partneriteti,

si dhe nga të gjitha parimet e cituara në protokollet apo procedurat standarde të veprimit të aplikueshme për menaxhimin e rasteve në mënyrë shumë-sektoriale të koordinuar, si dhe të miratuara për çdo institucion anëtar të MKR-së.

Të rëndësishme për t'u theksuar janë veçanërisht parimet themelore si në vijim:

- **Viktima në qendër të sistemit.** Shërbimet duhet të jenë të orientuara për nga viktima, nevojat dhe siguria e viktimave duhet të jenë konsiderata parësore.
- **Fleksibiliteti** duhet ta karakterizojë këtë model mekanizmi të koordinuar të referimit, me qëllim që të mund të adaptohet në çdo kontekst.
- **Vënia e dhunuesit përpara përgjegjësisë.** Dhunuesi duhet të mbajë përgjegjësi për veprimet e kryera. Anëtarët e MKR duhet ta vënë theksin te kjo përgjegjësi dhe ndërhyrjet duhen bërë me synimin që dhunuesi të mbajë përgjegjësi të plotë dhe të ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.
- **Qëndrueshmëria.** Është shumë e rëndësishme që MKR të ketë qëndrueshmëri, si financiare, ashtu edhe strukturore.
- **Zotërimi të vijë së brendshmi.** Bashkia duhet ta ndiejë të vetin këtë MKR që në momentin e krijimit të tij (duke u bazuar në legjislacion dhe në përshtatje me nevojat e specifikat e komunitetit dhe zonës ku do të veprojnë), si dhe duhet të sigurojë edhe pjesëmarrjen e OJF-ve në fazat e planifikimit dhe zbatimit. Modeli duhet të ngrihet mbi kapacitetet dhe burimet ekzistuese të shërbimeve sociale në nivel bashkiak, por me synimin e zgjerimit të mëtejshëm të burimeve financiare, njerëzore e infrastrukturore.
- **Protokolle të standardizuara.** Puna me rastin duhet të orientohet nga protokolle të standardizuara mes anëtarëve të MKR dhe po kështu edhe koordinimi mes tyre duhet të bazohet në protokolle të veçanta dhe në procedura standarde veprimi.
- **Përputhshmëri me ligjet.** Modeli duhet të jetë në përputhje me legjislacionin kundër dhunës në familje.
- **Vlefshmëria.** Një faktor kyç në ngritjen e reagimit ndaj dhunës në familje është përcaktimi i procedurave të qarta dhe lehtësisht të përdorshme për secilin anëtar të mekanizmit. Qytetaret/ qytetarët duhet të jenë në dijeni për ekzistencën e këtij MKR dhe strukturave të tij, komitetin drejtues dhe ekipin teknik ndërdisiplinor, si dhe duhet t'i njohin dhe kuptojnë detyrat dhe kompetencat e tij.
- **Burimet.** Burimet e komitetit drejtues dhe ekipit teknik ndërdisiplinor janë burimet ekzistuese të institucioneve përbërëse të tij, si dhe të tjera që mund të krijohen si rezultat i financimeve të reja nga buxheti qendror dhe vendor ose nga organizata të ndryshme donatore.

- **Zgjerimi i reagimit.** Një rol i rëndësishëm i MKR është edhe ai i përmirësimit të vazhdueshëm të trajtimit të rastit si dhe zgjerimit të burimeve që u ofrohen viktimave të dhunës në familje.

NENI 6

Angazhimet e palëve

6.1. Palët marrin përsipër këto angazhime të përbashkëta:

1. Vijimin e funksionimit të Komitetit Drejtues, organ ky i ngritur me përfaqësues nga të gjitha palët, që koordinojnë punën brenda juridiksionit territorial të Bashkisë FUSHE ARREZ, për identifikimin, mbrojtjen, mbështetjen, referimin dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje;
2. Vijimin e funksionimit të Ekipit Teknik Ndërdisciplinor (organ ky i ngritur me vendim të Komitetit Drejtues), me përfaqësues teknikë nga të gjitha palët;
3. Caktimin nga ana e Kryetarit të Bashkisë të personit përgjegjës në bashki që do të emërohet në pozicionin e Koordinatorës Vendore kundër Dhunës në Familje (KVDHF), si dhe dakordësimin mes të gjithë antarëve për të vënë në dispozicion të KVDHF, të dhënat dhe informacionin e nevojshëm për mbarëvajtjen e punës së MKR-së si dhe trajtimin me efektivitet të rasteve të dhunës në familje;
4. Fuqizimin e marrëdhënies bashkëpunuese ndërmjet institucioneve kryesore për trajtimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, përmes shkëmbimit të informacionit, hartimit të procedurave dhe protokolleve të përbashkëta për trajtimin e incidenteve të dhunës në familje dhe rritjen e efektivitetit të MKR për trajtimin me sukses të rasteve të të gjitha formave të dhunës në familje, përmes:
 - a. Trajtimin 24 orë në 7 ditë të javës të të gjitha nevojave të viktimave të të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, duke përdorur qasjen e viktimës në qendër;
 - b. Shkëmbimit të rregullt e periodik të informacionit, në përputhje me parimet e etikës dhe konfidencialitetit;
 - c. Hartimit të procedurave standarde të veprimit dhe protokolleve të përbashkëta për menaxhimin e rasteve, si dhe për ndërveprimin shumë-sektorial;
 - d. Mbledhjes së statistikave dhe të dhënave mbi fenomenin në tërësi, përmes formularëve e sistemeve të unifikuara, si dhe përdorimit të tyre për të përcaktuar nevojat, identifikuar pengesat dhe sugjeruar zgjidhjet e mundshme për rastet e dhunës në familje;
 - e. Respektimit të standardeve të shërbimeve të ofruara, duke i përputhur ato me standardet dhe kërkesat ndërkombëtare;
 - f. Shtimit dhe përmirësimit të shërbimeve për mbrojtjen, trajtimin dhe rehabilitimin e viktimave si dhe vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme në mënyrë të përbashkët e të koordinuar për funksionimin me efektivitet të këtyre shërbimeve;
 - g. Investimit në programet e rehabilitimit për dhunuesit;
 - h. Angazhimit në veprimtari trajnuese për të përmirësuar kapacitetet e specialistëve(eve) dhe punonjësve(eve) të cilët(at) merren në mënyrë të drejtpërdrejtë me menaxhimin e rasteve, por edhe të antarëve të Komitetit Drejtues të cilët(at) janë kryesisht në pozicionin politikë-bërës e vendim-marrës;

- i. Zhvillimit të partneriteteve dhe përgjigjes së përbashkët ndaj gjetjeve nga kontrollet dhe/ose auditet shtetërore, si dhe dhënies së rekomandimeve lidhur me përmirësimet ose ndryshimet që nevojiten;
- j. Përmirësimin të vazhdueshëm të MKR, përmes vlerësimit të vazhdueshëm të punës së ETN-së, si dhe duke synuar shtimin e antarësisë me institucione dhe shërbime në mbështetje të viktimave të dhunës në familje, në përputhje me legjislacionin dhe politikat në fuqi.

6.2. Bashkia merr përsipër:

1. Të kujdeset për ngritjen, konsolidimin, monitorimin dhe vazhdimësinë e punës së mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje, duke mbledhur sipas detyrimeve në fuqi, Komitetin Drejtues dhe Ekipin Teknik Ndërdisciplinar, si dhe duke i mbajtur të informuar periodikisht antarët(et) në periudhën mes dy mbledhjeve;
2. Të vijojë të luajë rol drejtues në konsolidimin, monitorimin dhe vazhdimësinë e punës së mekanizmit të referimit për trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
3. Të caktojë personin përgjegjës në pozicionin e Koordinatorës Vendore kundër Dhunës në Familje (KVDHF), si dhe të kujdeset për fuqizimin e kapaciteteve dhe qëndrueshmërinë në punë të këtij personi, duke i krijuar hapësirën dhe kushtet e nevojshme për të plotësuar të gjitha detyrimet ligjore të pozicionit të saj të punës, siç parashikohen në Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar dhe aktet e tjera nënligjore të lidhura me të, si dhe siç jepen të detajuara në përshkrimin e punës së këtij pozicioni, që paraqitet në shtojcën A të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi;
4. Të sigurojë mbështetjen dhe burimet e nevojshme për të lehtësuar punën e KVDHF në përmbushje të të gjitha detyrimeve ligjore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi;
5. Të angazhohet për krijimin e strukturave të specializuara të shërbimit social për rastet e dhunës në familje, lidhur me mënyrën e referimit të rasteve të dhunës në familje, si dhe monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes e të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes;
6. Të koordinojë punën me qendrat ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse dhe qendrave të emergjencës për trajtimin e menjëhershëm të viktimave të dhunës në familje, në përputhje edhe me parimin e “përshtatjes së arsyeshme”;
7. Të bashkëpunojë me organet ligjzbatuese për marrjen e masave për ndarjen e dhunuesit nga familja, me qëllim lënien në përdorim të banesës familjare viktimës dhe fëmijëve;
8. Të marrë masat për zbatimin e vendimit gjyqësor, nga organet vendore të vendbanimit dhe/ose vendqëndrimit të viktimës;
9. Të bashkëpunojë me shërbimin e provës, për monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen elektronike të personave që u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor;
10. Të vijojë grumbullimin e të dhënave të standartizuara mbi rastet që trajtohen në mënyrë të koordinuar (si dhe të dhëna të përgjithshme për dhunën ngaj grave dhe dhunën në familje), hedhjen e tyre në sistemin on-line të ngritur nga Ministria Shëndetësisë Mbrojtjes Sociale (MSHMS), sipas detyrimit ligjor përkatës, si dhe përcjelljen e raporteve të rregullta tek antarët e Mekanizmit të Referimit apo tek MSHMS, periodikisht dhe/ose sipas kërkesës;
11. Të hartojë/ përditësojë marrëveshjet e bashkëpunimit me ofruesit e shërbimeve përkatëse dhe institucionet e tjera që përfshihen në parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje;

12. T'a informojë viktimën ose personin që e shoqëron atë mbi shërbimet ekzistuese sociale dhe ta shoqërojë atë për në qendrat e duhura, duke siguruar transportin dhe një mbështetje të menjëhershme në ushqim e veshje, nëse është e nevojshme;
13. Të aplikojë me prioritet maksimal dhënien e mbështetjes ekonomike në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe aplikimin e bonusit të qerasë apo të strehimit social për viktimat e dhunës në familje të cilat janë pajisur me urdhërin e të mbrojtjes të përcaktuar me vendimin e gjykatës;
14. Të sigurojë banesa të specializuara për viktimat e dhunës në familje, sipas legjislacionit për strehimin social, në përputhje edhe me parimin e “përshtatjes së arsyeshme”;
15. Të ndërmjetësojë për adresimin e nevojave të antarëve të mekanizmit të koordinuar të referimit për informacion dhe ngritje kapacitetesh;
16. Të organizojë aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuuese për publikun, me fokus të veçantë gratë dhe të rejtat e të rinjtë;
17. Të planifikojë në buxhetet e saj vjetore, si dhe të koordinojë veprimet me donatorët dhe agjensitë ndërkombëtare për të siguruar fondet e nevojshme për trajtimin e nevojave emergjente dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, si dhe për funksionimin me efektivitet të MKR.
18. Të marrë masat e nevojshme që të mundësohet nga zyra e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore monitorimi dhe respektimi i urdhrin të mbrojtjes nga palët gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UMM/UM-në, dhe përgatitja çdo 60 ditë e raportit, për të cilin, në çdo rast, vihet në dijeni Policia e Shtetit.
19. Të angazhohet për zbatimin me përgjegjësi të të gjitha detyrave të përshkruara në legjislacionin në fuqi.

6.3. Prefektura Shkodër merr përsipër:

1. Të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e Komitetit Drejtues të MKR dhe të mbështesë punën e antarëve të tij;
2. Të ndërmjetësojë për adresimin e nevojave të paraqitura nga antarët e MKR, për një përgjigje sa më të plotë e të mirëkoordinuar kundër dhunës në familje;
3. Të bashkëpunojë sipas nevojave e mundësive, për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta me antarët e MKR, duke bërë dhe sugjerimet përkatëse në bazë të nevojave të identifikuara.

6.4. Stacioni i Policisë Fushë-Arrëz merr përsipër:

1. Të caktojë një punonjës(e) si antar(e) të Ekipit Teknik Ndërdisciplinor dhe të mundësojë pjesëmarrjen e tij(saj) në mbledhjet e ETN, sipas nevojës;
2. Të reagojë menjëherë ndaj të gjitha thirrjeve (njoftime telefonike apo thirrje institucionale) për dhunë në familje;
3. Të ndërhyjë në vendngjarje dhe të mundësojë mbrojtjen e viktimës dhe të personave të tjerë në varësi të saj, duke përdorur të gjitha mjetet ligjore në dispozicion, duke kryer procedurat, mbledhur provat dhe plotësuar dokumentacionin përkatës konform legjislacionit civil e penal në fuqi, si dhe në përputhje me procedurat standarde të veprimit të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
4. Të zbatojë detyrimin ligjor të kryerjes së vlerësimit të riskut të rastit. Punonjësi(ja) i Policisë së Shtetit kryen vlerësimin e riskut dhe harton raportin e vlerësimit të riskut të rastit të dhunës në familje, i/e asistuar nga koordinatorja vendore pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, ose në pamundësi të saj nga një punonjës(e) social(e) i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Hartimi i raportit

- kryhet sipas modelit të raportit të miratuar si aneks me aktet nënligjore të ligjit kundër dhunës në familje;
5. Të marrë masa, mbështetur në vlerësimin e riskut (në bashkëpunim me Koordinatorën Vendore) për hartimin e planit të sigurisë së viktimës;
 6. Të marrë menjëherë në mbrojtje fëmijët (kur viktimat e dhunës në familje janë fëmijë) dhe të referojë rastin pranë Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki ose punonjësve(eve) për mbrojtjen e fëmijëve në njësitë administrative të Bashkisë. Hartimi i raportit të vlerësimit të riskut nga policia kryhet në prani të njesisë/punonjësve(eve) për mbrojtjen e fëmijëve;
 7. Të verë në dijeni Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në bashki, kur nxjerr Urdhërin për Masa Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme (UMPMM) që vendos në mbrojtje të miturin ose që lëshohet ndaj dhunuesit/es së mitur;
 8. Të kërkojë informacion nga strukturat e Policisë së vendbanimit të viktimës, në rastet kur vendi ku është identifikuar ose raportuar rasti i dhunës në familje është i ndryshëm nga ai i vendbanimit të viktimës ose dhunuesit;
 9. Të kryejë vlerësimin e riskut me shpejtësi, bazuar në informacionin si rezultat i identifikimit ose raportimit të rastit të dhunës, si dhe të informacioneve të tjera që mund të mblidhen menjëherë nga pyetja e të dhunuarës, e dhunuesit ose e anëtarëve të tjerë të familjes, si dhe nga institucionet, organizatat ose individët, që kanë dijeni për rastin.
 10. T'i paraqesë titullarit të strukturës vendore të policisë raportin e vlerësimit të riskut duke sugjeruar marrjen e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, që duhet të urdhërohen në UMPMM për ndalimin e dhunës dhe mbrojtjen e viktimës, duke u bazuar në parimin e parandalimit të përshkallëzimit të dhunës dhe të proporcionalitetit me nivelin e rrezikut të dhunës, parimin e interesit më të lartë të fëmijës, si edhe shmangien e lënies së fëmijëve pranë dhunuesit;
 11. T'i paraqesë titullarit të strukturës vendore të policisë raportin e vlerësimit të riskut duke sugjeruar vendosjen e viktimës në një qendër rezidenciale ose emergjence, vetëm kur paraqitet e domosdoshme për shkak të riskut për jetën e saj, duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të fëmijëve të mitur për të mos qëndruar me dhunuesin/en në mënyrë të pambikëqyrrur, vullnetin e viktimës për t'u strehuar, si dhe legjislacionin në fuqi për standardet dhe procedurat për pranimin në këto qendra;
 12. Të transportojë viktimën në një vend të sigurt ose ta largojë dhunuesin për të garantuar sigurinë e viktimës dhe të personave në varësi të saj, si dhe të bashkëpunojë në çdo rast dhe sipas kërkesës së ETN për transportin e sigurt të viktimës në qendrat apo institucionet që ofrojnë shërbime, në përputhje me nevojat e saj; Transportimi i viktimës së dhunës në familje për në strehëz rekomandohet të kryhet në bashkëpunim me koordinatoren vendore kundër dhunës në familje ose një punonjëse të Zyrës/Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në bashki.
 13. Të ketë informacion mbi vendndodhjen e qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale, kur vlerëson riskun e një viktime të dhunës seksuale;
 14. Të paraqesë kërkesën për vlerësimin e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme pranë gjykatës kompetente, brenda 48 orëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri;
 15. Të zbatojë UMPMM në bashkëpunim me koordinatoren vendore të njesisë së vetëqeverisjes vendore, si dhe në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse në vendin e banimit, si dhe koordinatoren vendore përkatëse, nëse vendi i raportimit të dhunës është i ndryshëm nga vendi i banimit të anëtarëve të familjes ku ka ndodhur dhuna;
 16. Të informojë personin ndaj të cilit është dhënë UMPMM-ja, në lidhje me masat që parashikon UMPMM-ja dhe detyrimin e tij për ta zbatuar atë vullnetarisht.

17. Të evidentojë mos ekzekutimin vullnetar të UMPMM në kërkesën që i drejton gjykatës për vlerësimin e UMPMM-së;
18. Të informojë viktimën e dhunës në familje në lidhje me masat që parashikon UMPMM-ja;
19. Të bashkëpunojë me koordinatoren vendore për monitorimin e zbatimit të masave që vendos UMPMM-ja;
20. Të marrë masa për zbatimin e UMPMM duke ngarkuar me këtë detyrë specialistin(en) për krimet dhe ndihmës specialistin(en) e policisë së zonës ku ka ndodhur ngjarja/ku ka vendbanimin i/e dhunuara (viktima e dhunës);
21. Ta informojë viktimën dhe të kryejë e procedurat përkatëse në lidhje me kërkesat për lëshimin e Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes/ Urdhërit të Mbrojtjes (sipas rastit).
22. Të plotësojë dokumentacionin për çështjen penale dhe ta dërgojë atë në Prokurori (në përputhje me legjislacionin material dhe procedural Penal);
23. Të marrë masa të menjëherëshme për të njoftuar KVDHF, nëse policia kontaktohet e para për rastin, për të përmbushur së bashku nevojat emergjente të rastit si siguria, etj. KVDHF sapo kontaktohet organizon menjëherë takimin e antarëve të ETN (që veprojnë në nivel menaxhim rasti);
24. T'a informojë viktimën dhe ta referojë tek antarët e tjerë të MKR, për shërbime të mëtejshme të specializuara;
25. Të vlerësojë me seriozitet dhe profesionalizëm çdo rast konstatimi apo informimi të shkeljeve të urdhrave të mbrojtjes në kohën e duhur, për të garantuar sigurinë e viktimave;
26. Të marrë masa për përmirësimin e kapaciteteve të të gjithë personelit të policisë/komisariatit në lidhje me çështje të dhunës në familje, si dhe në kuadër të përgjigjes shumë-sektoriale të koordinuar, duke adresuar nevojën për trajnime edhe përmes KVDHF.

6.5. Spitali Pukë, merr përsipër:

1. Të caktojnë një person përgjegjës si anëtar/anëtar të ETN dhe të mundësojnë pjesëmarrjen rregullisht të saj/tij në mbledhjet mujore, si dhe për shkëmbimin e informacionit sipas kërkesës.
2. Të sigurojnë kujdes mjekësor të menjëhershëm dhe konfidencial sipas nevojës së viktimës, duke vënë në dijeni Koordinatoren Vendore dhe Komisariatin e Policisë, në përputhje me detyrimet dhe parashikimet në legjislacionin në fuqi.
3. Të ofrojnë në çdo kohë ndihmë mjekësore, sociale e psikologjike për viktimat e dhunës në familje.
4. Të bëjnë në çdo kohë ekzaminimet e nevojshme në institucionet shëndetësore publike përkatëse.
5. Të evidentojnë rastet e dhunës në familje në dokumentacionin përkatës mjekësor të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
6. Të pajisin edhe viktimën me raportin mjekësor përkatës, si dhe t'i paraqesin raportet e sakta gjykatës, duke respektuar parimin e konfidencialitetit.
7. Të referojnë dhe orientojnë viktimën pranë shërbimeve të tjera të mbështetjes dhe mbrojtjes nga dhuna në familje.
8. Të marrin masat e nevojshme për trajnimin e personelit mjekësor për identifikimin e dhunës në familje dhe të sigurojnë burimet dhe shërbimet për viktimat që mund të kërkojnë ndihmë, duke i referuar rastet sipas procedurave tek ETN.

6.6 Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër merr përsipër:

1. Të caktojë një person përgjegjës si antar(e) i ETN dhe të mundësojë pjesëmarrjen rregullisht të tij(saj) në mbledhjet mujore, si dhe për shkëmbimin e informacionit sipas kërkesës;
2. Të organizojë caktimin e gjyqtarëve(eve) përkatës(e) si dhe të marrë masa për shqyrtimin e çështjeve me prioritet dhe sipas afateve në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke ofruar shërbim gjyqësor korrekt për njoftimin e palëve si dhe marrjen e vendimeve për lëshimin e urdhërave të mbrojtjes;
3. Të marrë masat e nevojshme organizative për të garantuar rendin e sigurinë në gjykatë, mos cënimin fizik apo verbal të viktimave në ambjentet e gjykatës, garantimin e qetësisë
4. në përputhje me rregullat e miratuara me ligjin e posaçëm për pushtetin gjyqësor, si dhe në përputhje me parimet e trajtimit të viktimave të dhunës në familje;
5. Të kontibujë në rritjen e efektivitetit të punës së MKR-së duke shtruar për diskutim çështje që lidhen me rastet e dhunës në familje dhe vështirësitë e ndeshura nga gjykata në adresimin e plotë të tyre;
6. Të zbatojë legjislacionin kundër dhunës në familje, veçanërisht masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave pa diskriminim;
7. Të parashikojë sipas rastit, kryesisht, masa mbrojtëse për fëmijët që kanë pësuar dhunë ose kanë qenë të pranishëm kur është ushtruar dhunë në familje, në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose/dhe në urdhrin e mbrojtjes;
8. Të vlerësojë nevojat për trajnime të gjyqtarëve(eve) në këtë fushë;

6.7. Prokuroria pranë Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, merr përsipër:

1. Të caktojë një person përgjegjës si antar(e) i ETN dhe të mundësojë pjesëmarrjen rregullisht të tij(saj) në mbledhjet mujore, si dhe për shkëmbimin e informacionit sipas kërkesës;
2. Të marrë masat e nevojshme për të siguruar gadishmërinë 24 orë në 7 ditët e javës për ushtrimin e ndjekjes penale kur është përpara veprave të dhunës në familje dhe/ose shkeljes së UMM/UM;
3. Të ndihmojë viktimat me informacionin e nevojshëm në lidhje me prezantimin e akuzave penale për dhunën në familje, mënyrën e depozitimit të akuzave penale, dokumentacionin që nevojitet, si dhe për veprimet që duhet të kryejnë në vijim;
4. Të ushtrojë kryesisht ndjekjen penale kur nuk është i nevojshëm ankimi i viktimës;
5. Të njoftojë (si organi procedues) menjëherë viktimën për të drejtat dhe të mbajë procesverbal për njoftimin e saj²;
6. Të trajtohet nga organi procedues viktimat e mitur e veprës penale duke mbajtur parasysh moshën, personalitetin dhe rrethana të tjera, me qëllim shmangien e pasojave të dëmshme për zhvillimin dhe edukimin e saj të ardhshëm³.

6.8. Zyra Vendore e Përmbarrimit Gjyqësor merr përsipër:

1. Të caktojë një person përgjegjës si antar(e) i ETN dhe të mundësojë pjesëmarrjen rregullisht të tij(saj) në mbledhjet mujore, si dhe për shkëmbimin e informacionit sipas kërkesës;
2. Të marrë masa për ekzekutimin e menjëhershëm të vendimeve të gjykatës në lidhje me urdherat mbrojtës, në bashkëpunim me strukturat e policisë së shtetit dhe zyrën e

² LIGJ Nr.7905, datë 21.3.1995, i ndryshuar. Kodi i Procedurës Penale i RSH-së.

³ LIGJ Nr.7905, datë 21.3.1995, i ndryshuar. Kodi i Procedurës Penale i RSH-së.

shërbimeve sociale të njësisë vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim;

3. Të kërkojë ndihmën dhe bashkëpunimin me organet përkatëse (polici, prokurori) në rast konstatimi të vështirësive në zbatim të urdhërave apo në rast shkeljeje të tyre;
4. Të vendosë prioritete dhe të mos diskriminojë në zbatimin e detyrimeve të mësipërme, veçanërisht për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, orientimit seksual, aftësive të kufizuara, etj.

6.9. Mjeku Ligjor merr përsipër:

1. Të marrë masa të paraqitet sipas mundësisë edhe si antar(e) i ETN në mbledhjet mujore, si dhe të mundësojë shkëmbimin e informacionit sipas kërkesës;
2. Të marrë masa për ekzaminimin e menjëhershëm dhe sipas parametrave të kërkuara e me mjetet përkatëse, për të gjitha format e dhunës në familje;
3. Të mos diskriminojë në zbatimin e detyrimeve dhe kryerjen e ekspertizës mjeko-ligjore në kohë e me përgjegjshmëri, veçanërisht për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, orientimit seksual, aftësive të kufizuara, etj.

6.10. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor dhe Spitali, marrin përsipër:

1. Të caktojnë një person përgjegjës si antar(e) i ETN dhe të mundësojnë pjesëmarrjen rregullisht të tij(saj) në mbledhjet mujore, si dhe për shkëmbimin e informacionit sipas kërkesës;
2. Të sigurojnë kujdes mjekësor të menjëhershëm dhe konfidencial sipas nevojës së viktimës, duke vënë në dijeni Koordinatorin Vendore dhe Komisaratin e Policisë, në përputhje me detyrimet dhe parashikimet në legjislacionin në fuqi;
3. T'u venë në dispozicion viktimave dokumentacionin mbi lëndimet, si dhe raportet e saktë gjykatës, duke respektuar parimin e konfidencialitetit;
4. Të marrin masat e nevojshme për trajnimin e personelit mjekësor për identifikimin e dhunës në familje dhe të sigurojnë burimet dhe shërbimet për viktimat që mund të kërkojnë ndihmë, duke i referuar rastet sipas procedurave tek ETN.

6.11. Zyra Vendore Arsimore merr përsipër:

1. Të caktojë një person përgjegjës si antar(e) i ETN dhe të mundësojë pjesëmarrjen rregullisht të tij(saj) në mbledhjet mujore, si dhe për shkëmbimin e informacionit sipas kërkesës;
2. Të zhvillojë kurrikulat e nevojshme dhe të integrojë në programet ekzistuese informacionin e nevojshëm për dinamikën, incidentet, ligjin dhe burimet lidhur me dhunën në familje;
3. Të trajnojnë mësuesit(et) në lidhje me identifikimin, reagimin, burimet dhe ndjekjen e rasteve të dhunës në familje;
4. Të raportojë rastet e identifikuar të dhunës në familje, tek Koordinatorja Vendore;
5. Të marrë masat e nevojshme dhe të kujdeset për zbatimin e urdhërave mbrojtës, kur këto përcaktojnë detyrime për dhunuesin për të mos kontaktuar fëmijët apo për të mos iu afruar godinave arsimore (kopshte, shkolla, etj); në rast të shkeljes së këtyre urdhërave mbrojtës, drejtuesi/ja i institucionit duhet të njoftojë menjëherë policinë dhe Koordinatorin Vendore.

6.12. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës merr përsipër:

1. Të caktojë një person përgjegjës si antar(e) i ETN dhe të mundësojë pjesëmarrjen rregullisht të tij (saj) në mbledhjet mujore, si dhe për shkëmbimin e informacionit sipas kërkesës;

2. Të bashkëpunojë me ETN për monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen elektronike të personave që u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor.

6.13. Zyra Vendore e Punësimit merr përsipër:

1. Të caktojë një person përgjegjës si antar(e) i ETN dhe të mundësojë pjesëmarrjen rregullisht të tij (saj) në mbledhjet mujore, si dhe për shkëmbimin e informacionit sipas kërkesës;
2. Të përfshijë dhe trajtojë me prioritet të gjitha rastet e viktimave të dhunës në familje në programet për nxitjen e punësimit dhe formimit profesional;
3. Të marrë masa për sistemimin e këtyre viktimave në programe të caktuara të formimit profesional, varësisht nevojave të tyre;
4. Të shqyrtojë me prioritet dhe procedura të përshpejtuara, të gjitha rastet e dhunës në familje, që referohen nga MKR;
5. Të informojë dhe referojë rastin e dhunës në familje tek Koordinatorja Vendore, nëse është institucioni i parë që kontakton me një rast;
6. Të ndihmojë në sensibilizimin dhe informimin e komunitetit mbi mbrojtjen dhe ndihmën që mund t'ju ofrohet viktimave të dhunës në familje;
7. Të identifikojë dhe adresojë nevojat për trajnimin e personelit veçanërisht në lidhje me komunikimin, krijimin e besimit si dhe informimin e referimin e rasteve të dhunës në familje.

6.14. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve Sociale merr përsipër:

1. Të caktojë një person përgjegjës si antar(e) i ETN dhe të mundësojë pjesëmarrjen rregullisht të tij (saj) në mbledhjet mujore, si dhe për shkëmbimin e informacionit sipas kërkesës;
2. Të marrë pjesë në shqyrtimin dhe ndjekjen e rasteve, sipas nevojës, deri në përfundimin e tyre;
3. Të mbështesë ndjekjen e rastit sidomos me referimet që mund të nevojiten në institucione rezidenciale apo qendrat pritëse;
4. Të asistojë në përgatitjen e dosjes përkatëse të rastit duke u koordinuar me qendrat që ofrojnë këto shërbime.

6.15 Shoqata “QSNNN” merr përsipër:

1. Të caktojë një person përgjegjës si anëtar/anëtar i ETN dhe të mundësojë pjesëmarrjen rregullisht të saj/tij në mbledhjet mujore, si dhe për shkëmbimin e informacionit sipas kërkesës.
2. Të ofrojë shërbime sociale dhe të referojë rast pas rasti, për viktimat e dhunës në familje.
3. Të ofrojë strehëz falas për një afat të papërcaktuar për gratë, viktimat e dhunës në familje, si dhe për fëmijët e tyre, bazuar edhe në vendimet për UMM/UM të dhëna nga Gjykata si dhe në rregulloren e brendshme të funksionimit të kësaj organizate.
4. Të ofrojë asistencë ligjore falas për viktimat e dhunës në familje.
5. Të ofrojë ndërmjetësim për punësim për viktimat e dhunës në familje.
6. Të ofrojë këshillim psikologjik falas për viktimat e dhunës në familje si edhe për fëmijët e tyre.

6.16. Shoqata “ Gruaja te Gruaja” Shkodër, merr përsipër:

1. Të caktojë një person përgjegjës si anëtare/anëtar i ETN dhe të mundësojë pjesëmarrjen rregullisht të saj/tij në mbledhjet mujore, si dhe për shkëmbimin e informacionit sipas kërkesës.
2. Të ofrojë shërbime sociale dhe të referojë rast pas rasti, për viktimat e dhunës në familje.
3. Të ofrojë strehëz falas për një afat të papërcaktuar për gratë, viktimat e dhunës në familje, si dhe për fëmijët e tyre, bazuar edhe në vendimet për UMM/UM të dhëna nga Gjykata si dhe në rregulloren e brendshme të funksionimit të kësaj organizate.
4. Të ofrojë asistencë ligjore falas për viktimat e dhunës në familje.
5. Të ofrojë ndërmjetësim për punësim për viktimat e dhunës në familje.
6. Të ofrojë këshillim psikologjik falas për viktimat e dhunës në familje si edhe për fëmijët e tyre.
7. Të bashkëpunojë sipas nevojave e mundësive, për zhvillimin e aktiviteteve informuese e parandaluese të përbashkëta me anëtarët/anëtarët e MKR, duke dhënë mesazhe të qarta kundër dhunës në familje e dhunës ndaj grave.

6.17. Shoqata “Komuniteti Papa Xhovani XXIII ” Shkodër, merr përsipër:

1. Të caktojë një person përgjegjës si anëtare/anëtar i ETN dhe të mundësojë pjesëmarrjen rregullisht të saj/tij në mbledhjet mujore, si dhe për shkëmbimin e informacionit sipas kërkesës.
2. Të ofrojë shërbime sociale dhe të referojë rast pas rasti, për viktimat e dhunës në familje.
3. Të ofrojë strehëz falas për një afat të papërcaktuar për gratë, viktimat e dhunës në familje, si dhe për fëmijët e tyre, bazuar edhe në vendimet për UMM/UM të dhëna nga Gjykata si dhe në rregulloren e brendshme të funksionimit të kësaj organizate.
4. Të ofrojë asistencë ligjore falas për viktimat e dhunës në familje.
5. Të ofrojë ndërmjetësim për punësim për viktimat e dhunës në familje.
6. Të ofrojë këshillim psikologjik falas për viktimat e dhunës në familje si edhe për fëmijët e tyre.
7. Të bashkëpunojë sipas nevojave e mundësive, për zhvillimin e aktiviteteve informuese e parandaluese të përbashkëta me anëtarët/anëtarët e MKR, duke dhënë mesazhe të qarta kundër dhunës në familje e dhunës ndaj grave.

NENI 7

Personat e Kontaktit

1. Secila nga palët do të vendosë në dispozicion të bashkisë të dhënat mbi emrin, pozicionin dhe mënyrën e kontaktimit të personit që do të caktojë si antar(e) të ETN, *jo më vonë se pesë ditë* nga dita e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje. Administratorët e Njësive Administrative ose specialistë të autorizuar(a) prej tyre, janë gjithashtu antarë të ETN dhe ftohen të marrin pjesë në takimet periodike në varësi të rasteve që trajtojnë bashkërisht me KVDHF. Po kështu administratorët e njësive administrative ftohen të marrin pjesë edhe në mbledhjen e Komitetit Drejtues për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit për vijimin e punës së MKR.
2. Palët duhet të venë në dispozicion informacionin e kërkuar për rastet e dhunës në familje që trajtojnë çdo muaj, jo më vonë se data 5 e muajit pasardhës. Informacioni duhet të dërgohet tek Koordinatorja Vendore kundër Dhunës në Familje në Bashki, në mënyrë elektronike si dhe nëpërmjet një shkrese zyrtare.
3. Personat e kontaktit do të jenë përgjegjës(e) gjithashtu dhe për saktësinë e protokolleve, proces-verbaleve, listave dhe çdo dokumenti shoqëruar që ka të bëjë me informacionin e dhënë.

NENI 8

Takimet dhe raportimet

1. Palët do të angazhohen në nivel vendim-marrjeje në mbledhje të rregullta të Komitetit Drejtues, të cilat sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, së bashku me rregullat dhe procedurat e funksionimit të tij përcaktohen në rregulloren e miratuar për këtë qëllim nga Këshilli Bashkiak. Komiteti Drejtues mund të propozojë dhe marrë vendim mbi modalitetin e funksionimit të tij dhe përmbajtjen e rregullores përkatëse, që në mbledhjen e parë, pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.
2. Në nivel teknik, mbledhjet e ETN parashikohen të jenë të rregullta mujore dhe sipas rasteve. Në situata të veçanta, kur nuk ka pasuar asnjë rast të ri apo të mbartur nga muaji i mëparshëm për shqyrtim dhe menaxhim, si dhe kur nuk përkon me momentin e vlerësimit të ecurisë së punës, mbledhja e ETN mund të shtyhet për muajin pasardhës, me kushtin që KVDHF të ketë marrë paraprakisht miratimin e Kryetarit të Bashkisë (që është njëkohësisht dhe Kryetar i Komitetit Drejtues të MKR), si dhe që të dërgohet një njoftim elektronikisht dhe me shkresë zyrtare mbi arsyet e mos organizimit të takimit të rregullt mujor.
3. Palët duhet të konfirmojnë me shkrim marrjen e raportimit mujor përkatës që përgatitet nga KVDHF për ETN apo të raportit tre-mujor që përgatitet për Komitetin Drejtues, në lidhje me rastet e dhunës në familje dhe ecurinë e punës së MKR. Njëkohësisht duhet të konfirmohet me shkrim (të paktën elektronikisht) edhe marrja e çdo njoftimi apo dokumenti tjetër të përcjellë nga KVDHF.
4. KVDHF përgatit dhe një raport gjashtë mujor apo vjetor, në varësi të kërkesës dhe pas miratimit nga Kryetari i Bashkisë, e dorëzon atë pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe kundër dhunës në familje.
5. Palët duhet të bien dakord bashkërisht për modalitetin e komunikimit elektronik dhe zyrtar mes tyre, si dhe për formatet që do të përdorin në lidhje me raportimet mujore, periodike e vjetore, shkresat përcjellëse, ftesat e aktivitetëve, formatet e marrëveshjeve, etj

NENI 9

Dispozita të fundit

1. Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë marrëveshje bashkëpunimi, si dhe në legjislacionin në fuqi kundër dhunës në familje.
2. Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet pa afat të përcaktuar, por me mundësinë e rishikimit dhe përmirësimit të saj sipas kërkesës së antarëve apo bazuar dhe në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe politikave përkatëse, në këtë drejtim. Në rast të ndryshimit të ndonjë prej përfaqësuesve(eve) të institucioneve në nivel të Komitetit Drejtues, apo në rast të shtimit/ndryshimit të antarësisë së MKR marrëveshja mund të plotësohet me një amendim shtesë.
3. Pas nënshkrimit, një kopje e marrëveshjes i përcillet për dijeni dhe ministrisë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe kundër dhunës në familje.
4. Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me mirëkuptim, me bisedime ndërmjet tyre, si dhe duke mbajtur proces-verbalet përkatëse që i bashkëlidhen procedurës së vlerësimit vjetor të ecurisë së punës së MKR-së.
5. Pjesë përbërëse dhe e pandarë e kësaj marrëveshje bashkëpunimi, janë shtojcat bashkangjitur saj, si dhe ato që shtohen më pas me vendim të Komitetit Drejtues.

6. Për detyrimet e çdo institucioni anëtar të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, që nuk janë përmendur në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi referohemi në bazën ligjore të plotë të kësaj marrëveshjeje.
7. Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët dhe hartohet në 15 (*pesëmbëdhjetë*) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga një kopje për secilën palë.

Për BASHKINË FUSHË-ARRËZ

Z.HIL CURRI

Kryetar

Për PREFEKTUREN, SHKODËR

Zj.Majlinda Angoni

Prefekte

Për STACIONIN E POLICISË, FUSHË-ARRËZ

Z. Bardhi Ibraliu

Oficer

Për NJËSINË VENDORE TË KUJDESIT SHËNDETËSORË, PUKË

Zj.Besmira Aliaj

Drejtoreshë

Për SPITALIN, PUKË

Z. Qazim Arifaj

Drejtör

Për ZYREN VENDORE ARSIMORE, PUKË

Znj. Blerinda Pemaj

Drejtoreshë

Për ZYRA VENDORE E PUNËSIMIT, PUKË

Z. Pjetër Gjergji

Drejtor

Për DREJTORINË RAJONALE TË SHËRBIMIT SOCIAL, SHKODËR

Znj. Daniela Jakoja

Drejtoreshë

Për SHOQATËN “QSNNN”, FUSHË-ARRËZ

Znj. Pamela Gjinaj

Drejtoreshë

Për SHOQATEN “ GRUAJA TE GRUAJA”, SHKODËR

Zj.Trendelina Boriçi

Presidente

Për SHOQATEN “ KOMUNITETI PAPA XHOVANI XXIII”, SHKODËR

Zj.Mira Prekperaj

Drejtoreshë

Për GJYKATEN E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM, SHKODËR

Z. Arbër Çela

Kryetar

Për PROKURORINË PRANË SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM, SHKODËR

Z.Albert Murçaj

Prokuror

Për ZYREN VENDORE TE PËRMBARIMIT GJYQËSOR, PUKË

Z. Zef Kolombi

Kryetar

Për ZYREN VENDORE TË SHËRBIMIT TË PROVËS, PUKË

Z.Artan Seferi

Drejtor

Për MJEKUN LIGJOR, SHKODËR

Z. Dhori Toshi

Mjek

SHTOJCA A
PËRSHKRIMI I PUNËS I KOORDINATORËS VENDORE

I - TË DHËNA MBI POZICIONIN E PUNËS

Institucioni: Njësi e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV)
Njësi Administrative (NJA),

Drejtoria: Drejtoria e Shërbimeve Sociale (DSHS)

Raporton tek: Drejtori/e i/e Shërbimeve Sociale në Bashki

POZICIONI I PUNËS

**KOORDINATOR/E VENDOR/E PËR MENAXHIMIN E
RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE (DHF)**

I-HYRJE

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, (i ndryshuar deri në tetor 2020) dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 327, datë 02.06.2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimitin e viktimave të dhunës”, përcaktojnë detyrimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) për ngritjen dhe funksionimin e Mekanizimit të Koordinuar të Referimit (MKR) për rastet e dhunës në familje. Sipas pikës 27 të VKM 327/2021, pranë çdo bashkie caktohet Koordinatorja/Koordinatori Vendor për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, në zyra të dedikuara posaçërisht për kryerjen e këtij funksioni, i cili nuk ka në përshkrimin e punës mbivendosje me detyra të tjera.

Për më tej edhe në objektivin specifik III.2. të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 e më specifikisht në masën III.2.5 parashikohet “Përcaktimi i një personi të dedikuar vetëm si Koordinatorë / Koordinator Vendor kundër dhunës në familje në të gjitha bashkitë në vend”. Pra NJVV-të ngarkohen me përgjegjësi të drejtpërdrejta për ngritjen e mekanizmave të koordinuar

të referimit, përmes zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit të kësaj strategjie, përkatësisht sipas masave që synojnë zvogëlimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

II - PËRKUFIZIMI

Koordinatorja/ Koordinatori Vendor për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare (KV), është punonjësj/punonjësi pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, përgjegjës për referimin e menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. KV angazhohet për parandalimin, identifikimin, vlerësimin, trajtimin, menaxhimin, referimin dhe reduktimin e të gjitha formave të dhunës në familje, si për koordinimin dhe drejtimin e punës së Ekipit Teknik Ndërdisciplinor (ETN), të cilët ndjekin dhe menaxhojnë rastin deri në zgjidhjen e tij, në territorin e bashkisë.

III - QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT TË PUNËS

Koordinatori/ja vendor/e ka funksionin e menaxherit/es së rastit të dhunës në familje. Ai/ajo koordinon dhe drejton punën e Ekipit Teknik Ndërdisciplinor (ETN), si dhe siguron burime ose i referon rastet për shërbime të mëtejshme të specializuara, të tilla si strehim, këshillim dhe shërbime ligjore falas, mbështetje psikologjike, etj. Ai/ajo shërben si ndërmjetës për institucionet dhe organizatat që ofrojnë shërbime mbështetëse të specializuara, jep informacion gjithëpërfshirës dhe të përditësuar mbi situatën, si dhe lidh viktimën/të mbijetuarën me to, për të mundësuar kujdes dhe trajtim të menjëhershëm dhe afatgjatë, të ofruar me profesionalizëm dhe në përputhje me të gjitha procedurat dhe standardet e miratuara. Gjithashtu Koordinatori/ja Vendor/e asiston viktimat për njohjen e të drejtave të tyre dhe sigurimin e urdhërave të mbrojtjes, harton së bashku me to dhe antarët e ETN-së planin individual të sigurisë dhe ndërhyrjes për garantimin e mbrotjes dhe shërbimeve të specializuara, si dhe përgatit raportin për shëndetin mendor dhe gjendjen psiko-sociale të viktimës/të mbijetuarës. Në rast nevoje, sipas kërkesës së gjykatës paraqitet dhe jep informacionin e kërkuar në lidhje me rastin, si dhe bashkëpunon me efektivet e policisë për monitorimin e zbatimit të urdhërave të mbrojtjes. Ndonëse nga praktika rezulton se gratë përbëjnë numrin më të lartë të viktimave/të mbijetuarave të dhunës në familje, Koordinatori/ja Vendor/e zbaton detyrat dhe përmbush misionin dhe qëllimet e punës së tij/saj duke trajtuar me prioritet të gjitha rastet e dhunës në familje, pavarësisht nëse viktimë është grua apo një antar tjetër i familjes, përfshirë këtu të moshuarit/at dhe personat me aftësi të kufizuara. Ndërsa në rast se viktimë e dhunës në familje është fëmijë, Koordinatori/ja Vendor/e merr të gjitha masat për trajtimin me prioritet të rastit, përmes referimit të menjëhershëm në strukturat përkatëse në bashki për mbrojtjen e fëmijëve (punonjësi/ja apo njësia për mbrojtjen e fëmijëve).

IV – DETYRAT KRYESORE

1. Drejton punën e Ekipit Teknik Ndërdisciplinor, organizon takimet e këtij ekipi, dhe informon për ecurinë e punës së tij Komitetin Drejtues të MKR-së;
2. Koordinon Ekipin Teknik Ndërdisciplinor për rastet që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme dhe siguron burime ose shërbime reference për individët që kërkojnë strehim, asistencë ligjore falas, këshillim dhe të tjera mbështetje të nevojshme;
3. Koordinon punën me GTN-në dhe raporton në mbledhjet e përbashkëta të ETN-së me GTN-në, kur dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave shoqërohet edhe me dhunën ndaj fëmijëve ose kur përshihen fëmijët si dëshmitarë të dhunës në marrëdhëniet familjare.
4. Koordinon punën, duke bashkëpunuar me punonjësen/punonjësin social pranë strukturave të posaçme të shërbimeve sociale në bashki dhe administratorët shoqërorë/punonjëset/punonjësit socialë në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku ushtron veprimtarinë.

5. Koordinon punën me administratorët shoqërorë/punonjëset/punonjësit socialë të njësisve të vetëqeverisjes vendore në rastin kur bashkitë janë të organizuara me disa njësi të tilla, duke mbuluar me shërbime edhe zonat rurale e periferike.
6. Bashkëpunon me organet ligjzbatuese për marrjen dhe zbatimin e masave për ndarjen e dhunuesit nga familja, me qëllim lënien në përdorim të banesës familjare viktimës dhe fëmijëve dhe për zbatimin e vendimit gjyqësor.
7. Bashkëpunon me shërbimin e provës për monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen elektronike të personave që u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor.
8. Harton një listë të organizatave jofitimprurëse e të profesionistëve, të cilët ofrojnë shërbime falas për viktimat e dhunës (psikologjike, këshillim, shërbime mjekësore, juridike falas, strehim) dhe e përditëson atë vazhdimisht.
9. Ndërmjetëson me OJF-të, Policinë e Shtetit, shërbimet shëndetësore, gjykatat, Shërbimin e Provës, strukturat e shërbimit të ndihmës juridike, shërbimet sociale dhe institucione / organizata të tjera referimi për të marrë e dhënë informacion, për t'i lidhur viktimat me shërbimet, si dhe për të siguruar vazhdimësinë e kujdesit ndaj tyre.
10. Koordinon punën me qendrat sociale e të rehabilitimit për viktimat dhe ofrimin e shërbimeve për to, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse e qendrave të emergjencës për trajtimin e menjëhershëm të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, si dhe me qendrat publike për trajtimin, trajnimin dhe rehabilitimin e dhunuesve.
11. Sigurohet që dosjet dhe dokumentacioni rreth viktimave të jetë i saktë, i plotë dhe i përditësuar, si dhe siguron ruajtjen e kopjeve të urdhrave të gjykatës dhe të dokumentacionit të kërkuar. Merr një kopje të urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe ndjek zbatimin e tij.
12. Përditëson të dhënat për të gjitha rastet e dhunës në familje, të trajtuara nga ETN-ja në një bazë elektronike të mbajtjes së të dhënave, si dhe ndan një herë në muaj një informacion të përmbledhur për rastet e trajtuara me gjithë anëtarët e këtij ekipi. Për këtë qëllim, secili anëtar i ekipit ndërdisiplinor ka përgjegjësi që të përcjellë te KV, një herë në muaj, informacionin për të gjitha rastet e paraqitura apo të trajtuara nga institucioni i tij, pavarësisht nëse ndërhyrja ka qenë e përbashkët, ndërdisiplinore apo është trajtuar vetëm brenda për brenda institucionit të vet.
13. Sigurohet që viktimat të marrin kërkesat për paraqitje në gjykatë, urdhrat e lëshuar nga gjykata për ndjekjen e hapave të duhur në rast shkeljeje të urdhrave të gjykatës, si dhe sigurohet që të kryhen të gjitha llojet e ndërhyrjeve të nevojshme në përputhje me ligjin.
14. Asiston viktimat në njohjen e të drejtave të tyre dhe në ndjekjen e procedurave të nevojshme për marrjen e një urdhri mbrojtjeje (UM)/urdhri të menjëhershëm të mbrojtjes (UMM), si dhe për hapat që duhen ndjekur, nëse urdhri shkelet.
15. Shoqëron viktimat e dhunës në gjykatë, polici dhe/ose pranë shërbimeve të tjera.
16. Harton planin e përbashkët të ndërhyrjes (PPN), sikurse parashikohet në VKM 327/2021.
17. Monitoron, gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UMM/UM-në, respektimin e urdhrin të mbrojtjes nga palët dhe çdo 60 (gjashtëdhjetë) ditë përgatit një raport, për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë e Shtetit.
18. Bashkëpunon për të siguruar vizitat në banesën e viktimës sipas vendimit të gjykatës për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes dhe/ose urdhrin e mbrojtjes, duke dhënë edhe informacionin e nevojshëm.
19. Koordinon organizimin e trajnimeve të ndërmarra nga strukturat përgjegjëse, sipas ligjit nr. 125/2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, 'Për masa

ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’, të ndryshuar”, për ekipin teknik ndërdisiplinor dhe personelin tjetër që punon me komunitetin.

20. Mbështet informimin e anëtarëve të komunitetit, të profesionistëve dhe organizatave jofitimprurëse rreth dhunës në familje dhe shërbimin me materiale ose botime të ndryshme sensibilizuese e ndërgjegjësuere për dhunën.
21. Harton marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore për realizimin e detyrave në funksion të zbatimit të legjislacionit në fuqi për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, në përputhje me përcaktimet e marrëveshjes së bashkëpunimit tip dhe ia propozon ato komitetit drejtues për miratim në parim.
22. Paraqet raporte mujore, tremujore dhe vjetore përpara komitetit drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, në formë të përmbledhur, duke u kujdesur që të ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave. Këto raporte përmbajnë informacion për rastet në të cilat është ndërhyrë, për procedurat e ndjekura, masat e ndërmarra dhe problemet e ndeshura, që mund të kërkojnë zgjidhje nga komiteti drejtues.
23. Identifikon protokollet ekzistuese në komunitet ose marrëdhënie informale bashkëpunimi që janë të suksesshme.
24. Propozon krijimin e shërbimeve të nevojshme për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare në strukturën e shërbimeve sociale pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore.
25. Është anëtar i grupit që përgatit planet sociale, ku analizohen nevojat sociale dhe parashikohen masat për përmirësimin ose ngritjen e shërbimeve të reja për subjektet e përfshira në dhunën në familje, si dhe anëtar i grupit që përgatit planet vendore për barazinë gjinore në nivel vendor.

V – ZGJIDHJA E PROBLEMEVE

Ky pozicion pune kërkon njohuri profesionale në lidhje me çështjen e dhunës në familje, si dhe menaxhimin e referimin e rasteve; shprehi kordinimi, komunikimi, analitike dhe të zgjidhjes së problemeve; gjithashtu kërkon aftësi në menaxhimin e situatave dhe evidentimin e detyrave prioritare, duke mbajtur në konsideratë një sërë dokumentash strategjike, të politikave apo programeve të caktuara mbi dhunën në familje. Kjo kërkon aftësi për të përpunuar dhe prezantuar informacion ndaj një publiku të larmishëm, në mënyrë që ata ta kuptojnë këtë informacion dhe ta përdorin për të marrë vendime. Të gjitha problemet e evidentuara gjatë punës për drejtimin dhe koordinimin e antarëve të ETN-së duhet të adresohen me prioritet dhe mecuri, duke mundësuar komunikim të hapur dhe efektiv me secilin antar dhe një zgjidhje të situatave ku si antarët e ETN-së ashtu edhe viktimat/të mbijetuarat e dhunës në familje të dalin të fituar. Kjo kërkon njohuri shumë të mira të bazës ligjore mbi të cilin mbështetet krijimi i këtij pozicioni pune; rolit, detyrave e përgjegjësi të çdo antari të MKR-së; njohjen e të drejtave dhe mjeteve në dispozicion për mbrojtjen e viktimave/të mbijetuarave, si dhe të burimeve mbështetëse në dispozicion, etj.

VI – VENDIMARRJA

Procesi i vendimarrjes kërkon aftësinë për të komunikuar dhe koordinuar aktivitete përmes aktorëve të ndryshëm dhe të marrjes së vendimeve bazuar në standardet dhe ose procedurat administrative të lidhura me bashkinë.

VII - MJEDISI MENAXHERIAL

Koordinatori/ja Vendor/e raporton dhe përmbush udhëzimet e Drejtorit/es të Shërbimeve Sociale të NJVV-së. Puna në këtë pozicion ka ndikim në besueshmërinë dhe integritetin e pushtetit vendor në Shqipëri dhe lidhet me një gamë të gjerë të politikave kombëtare.

VIII - SUPERVIZIMI

Nën supervizimin e Drejtorit/es të Shërbimeve Sociale në Njësinë e Vetëqeverisjes Vendore.

IX – KUSHTET E PUNËS

Sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin, politikat dhe procedurat e funksionimit të punonjëseve dhe punonjësve të administratës publike dhe njërive të vetëqeverisjes vendore.

X – KËRKESAT RESPEKTIVE

Edukimi: Aplikuesi/ja duhet të ketë përfunduar studimet universitare dhe duhet të zotërojë një diplomë Bachelor në Punë Sociale/Psikologji si dhe studime pasuniversitare në fushën psiko-sociale.

Eksperienca: Kërkohen të paktën 3 vite eksperiencë në një pozicion të ngjashëm

Tjetër: Mbajtësi/ja i/e këtij pozicioni duhet të ketë:

- Njohuri mbi legjislacionin e barazisë gjinore dhe dhunës në familje.
 - Kualifikime në fushën e barazisë gjinore (integritet gjinor, buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, etj) si dhe dhunës në familje.
 - Njohuri mbi politikat e decentralizimit dhe deinstitutionalizimit.
 - Njohuri të vecanta mbi reformat në lidhje me shërbimet sociale dhe përfshirjen sociale.
 - Aftësi në administrim, vecanërisht në administrimin e vetëqeverisjes vendore.
 - Aftësi në shkrimin e raporteve dhe mbledhjen e të dhënave .
 - Aftësi për të punuar në skuadër.
 - Aftësi për të ofruar këshilla ndaj anëtarëve të Ekipit Teknik Ndërdisciplinor mbi menaxhimin e rastit, planifikimin dhe analizën e rastit.
 - Aftësi për të kuptuar qasjet e menaxhimit të rastit dhe bashkëpunimin ndërsektorial.
 - Shprehi të shkëlqyera ndërpersonale.
 - Shprehi të shkëlqyera komunikimi.
-
- Aftësi të përdorimit profesional të programeve kompjuterike.

XIII - NËNSHKRIMI

Dokumenti është i vlefshëm i shtypur dhe nënshkruar në datën e caktuar!

Drejtori/ja

Supervizori/ja direkt

Punonjësi/ja:

